



**Manual për Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës, Anëtarë të Grupit Teknik Ndërsektorial në Lezhë dhe Durrës, për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve të Huaj të Pashoqëruar dhe të Ndarë dhe Mbrojtjen e Tyre nga Shfrytëzimi dhe Dhuna Seksuale**









**Manual për punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, anëtarë të Grupit Teknik Ndërsektorial në Lezhë dhe Durrës, për menaxhimin e rasteve të Fëmijëve të Huaj të Pashoqëruar dhe të Ndarë dhe mbrojtjen e tyre nga shfrytëzimi dhe dhuna seksuale**



## **Manuali u hartua nga:**

**Zyhrada Kongoli**, Konsulente Ligjore e Pavarur

Ky publikim u realizua në bashkëpunim me Terre des hommes në kuadër të projektit "Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbime të parandalimit dhe përgjigjes cilësore kundër abuzimit, dhunës dhe neglizhimit".

Financuar nga UNICEF, zbatuar nga Nisma Arsis në bashkëpunim dhe Terre des hommes dhe Plan and Go.

## **Shënim**

Ky manual nuk është një akt detyrues por rregullimet dhe hapat procedurale të ofruara këtu janë të natyrës shpjeguese dhe bazohen në legjislacionin përkatës në fuqi. Ky dokument ka për qëllim të sigurojë një kuptim uniform nga ana e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe të sigurojë mjete për të realizuar zbatimin korrekt dhe të harmonizuar të dispozitave ligjore përkatëse.

Në çdo rast, rregullimet ligjore kanë përparësi ndaj përmbajtjes së këtij dokumenti dhe duhet të konsultohen në rast mëdyshjeje. Për këtë qëllim manuali jep edhe referencat ligjore përkatëse.

## Shkurtime

<b>GTN</b>	Grupi Teknik Ndërsektorial
<b>FHPN</b>	Fëmijë i Huaj i Pashoqëruar dhe i Ndarë
<b>LGBTI</b>	Lezbike, gej, biseksualë, transeksualë, interseksualë
<b>OJF</b>	Organizatë jofitimprurëse
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>KDF</b>	Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve
<b>NJVNRR</b>	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve
<b>NJMF</b>	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
<b>NjVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>PMF</b>	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>QPA</b>	Qendra e Pritjes për Azil

## Përkufizime

Për qëllim të këtij manuali dhe në përputhje me rregullimet në legjislacionin përkatës, termat e mëposhtme do të kenë këtë kuptim:

**“Fëmijë”** është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë në kuptim të këtij manuali derisa mosha të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

**“Fëmijë i pashoqëruar”** është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi nën 18 vjeç, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për të, sipas ligjit ose sipas traditës, ose është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për sa kohë ai nuk është efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë.

**“Fëmijë i ndarë”** është një fëmijë nën 18 vjeç, i cili ndodhet jashtë shtetit të origjinës dhe i ndarë nga të dy prindërit ose kujdestari i tij i mëparshëm ligjor ose i zakonshëm.

**“Mbrotjtje e fëmijës”** është parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

**“Kujdestar ligjor”** është personi i caktuar nga gjykata për fëmijën e pashoqëruar, i cili vepron në emër dhe për llogari të këtij të fundit gjatë gjithë procedurës së përcaktimit të statusit të mbrotjtjes ndërkombëtare apo vetëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, përveç rastit kur me ligj kërkohet që vetë kërkuesi të kryejë personalisht një veprim të caktuar procedural.

**“Shfrytëzim seksual”** është çdo abuzim aktual ose i mbetur në tentativë i një pozicioni të cenueshëm, pozite të diferencuar pushteti ose besimi për qëllime seksuale, që përfshin por pa u kufizuar vetëm në përfitim financiar, social ose politik nga shfrytëzimi seksual i një tjetri.

**“Abuzim seksual”** është një ndërhyrje fizike aktuale ose kërcënimi për një të tillë, e natyrës seksuale, qoftë me forcë ose i ndodhur në kushte të pabarabarta ose shtrënguese.



## Hyrje

Ky manual ka për qëllim të shërbejë si dokument pune dhe të ofrojë, në mënyrë të përmbledhur dhe në përputhje me kuadrin ligjor përkatës në fuqi, procedurat që duhet të ndiqen nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) edhe si pjesë e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) për menaxhimin e rasteve të Fëmijëve të Huaj të Pashoqëruar dhe të Ndarë (FHPN) me qëllim mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi seksual.

Në fillim ky manual është menduar të hartohet për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të vijës së parë që veprojnë në zonën e Lezhës e Durrësit ku, që prej muajit gusht 2021, janë vendosur në mënyrë të përkohshme rreth 4000 qytetarë afganë, ndërmjet të cilëve dhe një numër i konsiderueshëm fëmijësh. Grupi i synuar nga ky manual janë fëmijët afganë, por ai është i vlefshëm për të gjithë PMF-të që menaxhojnë raste të fëmijëve të ndarë nga prindërit dhe familjet e tyre si pasojë e situatave të konfliktit dhe zhvendosjes së popullsisë.

Ky dokument merr në konsideratë, për aq sa është e mundur, rrethanat dhe vështirësitë specifike të FHPN-ve që lidhen kryesisht me kufizimet që kanë për shkak të situatës personale, moshës dhe aftësisë për të kuptuar, si dhe për të qenë të ndërgjegjshëm dhe për të kërkuar zbatimin e të drejtave të njohura me ligj. Këtyre vështirësive u shtohet edhe kufizimi që këta fëmijë kanë për shkak të mosnjohjes së gjuhës së vendit ku vendosen.

Nga ana tjetër, nga pikëpamja e menaxhimit të situatave, flukset masive, pjesë e të cilave janë edhe një numër i konsiderueshëm FHPN-sh, shoqërohen me vështirësi shtesë që lidhen me burimet e pamjaftueshme njerëzore, infrastrukturore dhe financiare. Në shumë raste mungojnë planet e emergjencave për menaxhimin e situatave të fluksit, plane të cilat duhet të përfshijnë edhe parashikueshmëritë financiare dhe burime shtesë që duhet të jenë të disponueshme për t'u përdorur për menaxhimin e situatave. Ndërkohë që zhvillimet më të fundit, si lufta në Ukrainë, e kanë bërë më të paqëndrueshme paqen dhe sigurinë dhe për këtë shkak është rritur edhe fluksi i lëvizjeve migratore.

Për këto arsye, ky manual synon të lehtësojë sa është e mundur punën e punonjësve të vijës së parë, kryesisht PMF-të, duke ofruar në mënyrë të përmbledhur rregullimet ligjore përkatëse që duhet të zbatohen në lidhje me menaxhimin e rasteve, referimin dhe monitorimin e vazhduar.

Procedurat e ofruara në mënyrë të përmbledhur në këtë dokument synojnë menaxhimin efektiv të rasteve nga ana e PMF-ve për të ofruar mbrojtje për fëmijët afgangë të pashoqëruar dhe të ndarë dhe, në veçanti, mbrojtje nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Manuali bazohet edhe në përvojën e deritanishme që punonjësit e vijës së parë kanë në lidhje me menaxhimin e rasteve të FHPN-ve, por edhe në praktikat e mira të vendeve të tjera. Ndërmarrja e veprimeve të përshtatshme dhe të bashkërenduara në fazën fillestare të identifikimit të FHPN-ve është parakusht për realizimin e një mbrojtjeje efektive nga rreziqet që mund të dëmtojnë jetën, shëndetin, moralin dhe zhvillimin normal të fëmijës.

Megjithëse manuali është konceptuar për t'u shërbyer PMF-ve, në rolin e profesionistëve të vijës së parë, ofrues të shërbimeve publike, për aq sa është e mundur ky manual do të udhëheqë edhe punën e aktorëve jopublikë e organizatave jofitimprurëse për të siguruar përpjekje të koordinuara dhe efektive në trajtimin e nevojave të shumëllojshme të FHPN-ve.

## Qëllimi

Qëllimi i hartimit të këtij manuali është zbatimi efektiv dhe uniform i legjislacionit përkatës dhe kërkesave që lidhen me respektimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës që i përket kategorisë FHPN.

Koncepti i mbrojtjes përfshin të gjitha veprimtaritë që synojnë respektimin e plotë të të drejtave të fëmijës siç parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi për azilin, për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës, shërbimet e kujdesit shoqëror, arsimin dhe sigurimin e kujdesit shoqëror.

Ky manual ka për qëllim të shërbejë si udhëzues gjithëpërfshirës dhe të ofrojë një kuadër të përmbledhur rregullator që përmban hapat proceduralë për të siguruar mbrojtje efektive në procesin e menaxhimit të rasteve të FHPN-ve. Ai do të shërbejë edhe si instrument për aktivizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes dhe për të siguruar ndërveprim efektiv të shërbimeve të nevojshme në të gjitha fushat, veçanërisht ato të mirëqenies sociale, shëndetit e sigurisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohen këta fëmijë, veçanërisht shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Manuali përmban veprimet procedurale, afatet e realizimit të tyre, llojet e mbështetjes së ofruar nga identifikimi i FHPN-ve, si dhe referimin e tyre, duke identifikuar edhe institucionet përgjegjëse. Përveç institucioneve publike, një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e situatave të FHPN-ve kanë edhe organizatat e shoqërisë civile, por edhe komunitetet ku vendosen këta fëmijë, ndërsa suksesi i menaxhimit të situatave komplekse kërkon më shumë përfshirje, aftësi, njohuri, por edhe burime njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

## Mbrojtja nga Abuzimi dhe Dhuna Seksuale

Një tjetër objektivi i rëndësishëm i këtij dokumenti është mbrojtja e FHPN-ve nga dhuna dhe abuzimi seksual nga ofruesit e shërbimeve parësore dhe mbështetëse. Ky është një aspekt shumë kritik i ofrimit dhe dhënies së ndihmës ndaj kësaj kategorie të cënueshme përfituesish, që në shumë raste kanë histori të mëparshme dhune ose abuzimi.

Për arsye të ndjeshmërisë së lartë që ka çështja e mbrojtjes dhe sigurimit të të drejtave të fëmijës, por edhe ekspozimit të kësaj kategorie të cënueshme ndaj dhunës dhe abuzimit, ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës ka përcaktuar kritere pranimi ose përjashtimi për punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, por edhe për punonjës të institucioneve apo agjencive të tjera që punojnë me fëmijët. Në zbatim të ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës janë miratuar kritere më të detajuara për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët<sup>1</sup>.

Aktin nënligjor zgjeron rrethin e personave që punojnë me fëmijët duke përfshirë profesionistët që punojnë si punonjës socialë apo psikologë dhe përkufizon se çfarë përfshin rrethi i punonjësve që punojnë me fëmijët. Përveç punonjësve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës që janë lehtësisht të identifikueshëm, kategoria e punonjësve që punojnë me fëmijët përfshin ata punonjës që punojnë në institucione të tjera, jo vetëm publike por edhe private, puna e të cilëve, qoftë e paguar apo vullnetare, përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët. Më tej është përkufizuar dhe çfarë konsiderohet kontakt i drejtpërdrejtë, i cili mund të jetë fizik nëse ndodhen në një hapësirë me fëmijën ose verbal, i shkruar apo elektronik.

Kriteret përfshijnë jo vetëm kritere profesionale, etike, të qenit i padënuar, por edhe detyrimin që këta punonjës të kenë trajnime dhe certifikime në fushën e fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

Legjislacioni shqiptar njih dhe i referohet rolit dhe nevojës së bashkëpunimit me UNHCR-në. Organizata e Kombeve të Bashkuara i ka dhënë një rëndësi të veçantë rrezikut nga dhuna dhe abuzimi seksual në situata emergjence. Për këtë qëllim, UNHCR-ja dhe organizatat e saj partnere kanë krijuar mekanizma që parandalojnë dhe sanksionojnë dhunën dhe abuzimin seksual në çdo kohë,

1 VKM Nr. 186, datë 04.04.2019 "Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët"

veçanërisht në situata emergjence. Një mekanizëm është Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm ku duhet të raportohen menjëherë sjelljet e parregullta ose të paligjshme që lidhen me dhunën dhe abuzimin seksual nga punonjësit që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje në situata emergjence.

Në mënyrë më të detajuar, Buletini i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara<sup>2</sup>, parashikon masat e veçanta për mbrojtjen nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual dhe detyrat e njësisë të ndryshme të organizatës për të vepruar në mënyrë aktive, për të krijuar dhe siguruar një mjedis që parandalon dhunën dhe abuzimin seksual.

---

2 [https://www.unhcr.org/protection/operations/405ac6614/secretary-generals-bulletin-special-measures-protection-sexual-exploitation.html#\\_ga=2.185321774.666956443.1658502275-699027388.1658502275](https://www.unhcr.org/protection/operations/405ac6614/secretary-generals-bulletin-special-measures-protection-sexual-exploitation.html#_ga=2.185321774.666956443.1658502275-699027388.1658502275)

## Parimet

Përveç parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe parimeve të veçanta të referuara në ligjin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, manuali bazohet ngushtësisht në parimet e mëposhtme:

*Parimi i interesit më të lartë të fëmijës:* Autoritetet publike dhe jopublike dhe punonjësit e tyre kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijën. Ky parim duhet të merret në konsideratë edhe nga Grupi Teknik Ndërsektorial kur të vendosin për interesin më të mirë të FHPN-së. Në zbatimin e këtij parimi, ata duhet të mbajnë parasysh situatën e veçantë të fëmijës në lidhje me faktin që është i pashoqëruar dhe i ndarë, rrethanat nëse ka pasur histori të mëparshme dhune, abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi apo forma të tjera të dhunës, si edhe rrezikun e mundshëm nga shfrytëzimi dhe dhuna seksuale.

*Parimi i bashkimit familjar:* Fëmijës që i përket kategorisë FHPN duhet t'i ofrohen shërbime që synojnë, ndër të tjera, ribashkimin e tij familjar, duke i dhënë më shumë prioritet fëmijëve më të lënduar dhe që janë më të cenueshëm nga rreziku i shfrytëzimit dhe dhunës seksuale.

*Parimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të fëmijës:* Përgjatë procesit të sigurimit të mbrojtjes për FHPN-në duhet të garantohet pjesëmarrja e fëmijës duke e dëgjuar dhe respektuar mendimin e tij në përputhje me moshën dhe aftësinë për të kuptuar. Për më shumë, fëmija duhet të informohet në mënyrë të vazhduar rreth planit të vendosjes në një vend të caktuar, shërbimeve që do t'i ofrohen dhe gjurmimit drejt ribashkimit familjar.

## Grupi i synuar / Profili i Fëmijëve të Huaj të Pashoqëruar e të Ndarë

Fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë nga prindërit e familjet e tyre, për shkak të zhvendosjes së popullsinë në kushtet e pasigurisë, si në rastin e popullsisë afgane, janë ndër kategoritë më të lënduara dhe të cenueshme nga rreziqet e shfrytëzimit. Për këtë arsye edhe ligji për të huajt i përfshin në përkufizimin e personave të cenueshëm.

Situata e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë nga familjet e tyre karakterizohet nga gamë e gjerë rrethanash të pafavorshme dhe të dëmshme për shëndetin e mirëqenien e tyre emocionale dhe fizike. Një pjesë e këtyre fëmijëve edhe përpara se të ndodheshin në situatën e FHNP-së, por edhe ndërsa ndodheshin në vendin e origjinës, kanë pasur histori të rrezikut të varfërisë ose përjashtimit social, kanë qenë viktime të dhunës nga shkolla, institucionet, prindërit apo kujdestarët e tyre, janë detyruar të punojnë apo kanë pasur histori të ekspozimit në internet ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme. Akoma më e cenueshme dhe kritike mund të jetë situata e FHPN-ve vajza, veçanërisht atyre që kanë histori të mëparshme abuzimi apo shfrytëzimi, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve LGBTI.

Në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës,<sup>3</sup> por edhe për shërbimet e kujdesit shoqëror<sup>4</sup>, FHPN-të për shkak të karakteristikave të cenueshmërinë klasifikohen në grupin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, madje për mbrojtje të veçantë. Nga ana tjetër, ky legjislacion zbatohet edhe për fëmijët e huaj, pa shtetësi dhe refugjatët që ndodhen brenda territorit të RSH-së.

3 Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

4 Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

Çdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit, të garantuar nga një kuadër i gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto instrumente që trajtojnë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, në shumicën e rasteve, i drejtohen fëmijës në njëjës për të theksuar rëndësinë e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të çdo individi fëmijë.

Pjesë e kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës janë bërë edhe nëntë traktatet bazë të të drejtave të njeriut, mes të cilëve edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, të cilët janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Vendi ynë ka ratifikuar dhe raporton periodikisht pranë KDF-së për Protokollin Opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, si dhe Protokollin Opsional për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura. Për më tepër, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin Opsional për procedurën e komunikimit, sipas të cilës fëmijës i njihet e drejta t'i drejtohet një mekanizmi ndërkombëtar specifik për të, kur mekanizmat kombëtarë nuk arrijnë t'i trajtojnë në mënyrë efektive shkeljet.

Nga ana tjetër, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, ka miratuar një rekomandim<sup>5</sup> për shtetet anëtare, në lidhje me kujdestarinë efektive për FHPN-ve në kontekstin e migracionit. Ky rekomandim është hartuar për të trajtuar nevojat e kësaj kategorie të cënueshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore për jetën, zhvillimin e mirëqenien, shëndetin, edukimin, strehimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës dhe shfrytëzimit. Sistemi i kujdestarisë efektive përbën një garanci themelore për mbrojtjen e të drejtave të FHPN-ve, sepse kujdestarët luajnë një rol kyç për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe ushtrimin e të drejtave të tyre.

Ky rekomandim synon të udhëzojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë RSH-në, duke ofruar parimet udhëheqëse për një sistem efektiv kujdestarie nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe politikash që siguron caktimin pa vonesa të kujdestarit, si edhe nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të standardeve profesionale, etike, dhe procedurave operacionale, në kontekst kombëtar dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

---

5 Rekomandim KM/Rec(2919)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për kujdestarinë efektive të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë, në kontekstin e migracionit.



Ndërkohë, kuadri ligjor i miratuar nga kuvendi i Republikës së Shqipërisë përmban parime, por edhe rregullime, në lidhje me hyrjen, qëndrimin, dhënien e statusit dhe kushte të tjera për integrimin e refugjatëve dhe në veçanti FHPN-ve gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

Parimet e përgjithshme kushtetuese<sup>6</sup> i vendosin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në themel të rendit juridik duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme. Në këtë kuadër, Kushtetuta parashikon që organet publike, në përmbushje të detyrave të tyre dhe në përputhje me fushën e përgjegjësisë, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Sipas nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e shtetit ndaj shtetasve shqiptarë, vlejnë njëjloj edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur ushtrimi i të drejtave dhe lirive të caktuara lidhet në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare. Të huajt kanë të drejtën e strehimit në vendin tonë, sipas legjislacionit përkatës. Në mënyrë të posaçme, fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Çdo fëmijë ka të drejtë të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi<sup>7</sup>.

Për sa u përket kushteve dhe procedurave të hyrjes, dhënies së statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme, këto aspekte trajtohen nga *Ligji për azilin*<sup>8</sup>. Ky ligj përcakton edhe të drejtat dhe detyrimet e shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, kërkues për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e RSH-së, personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, si edhe të drejtën për bashkim familjar dhe kushtet për integrimin e tyre gjatë qëndrimit në RSH. Ligji për azilin i konsideron FHPN-të dhe të gjithë fëmijët, sikurse edhe fëmijët LGBTI, me aftësi të kufizuara, me sëmundje të rënda, me probleme dhe çrregullime të shëndetit mendor, si dhe fëmijët që kanë qenë subjekt i çdo forme të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale, si persona që i përkasin kategorisë së veçantë. Fëmijëve të kësaj kategorie i kushtohet vëmendje, trajtim dhe kujdes i veçantë, por edhe trajtim i diferencuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor, si dhe këshillimin psiko-social<sup>9</sup>.

6 Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

7 Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8 Ligji Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

9 Neni 23 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

Individëve të trajtuar sipas ligjit për azilin, u ofrohen garanci të mjaftueshme dhe respektimi i parimit të moskthimit, në përputhje me kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe kriteret pranuese dhe përjashtuese. Kërkesve për mbrojtje ndërkombëtare u garantohej ndihmë ligjore dhe informacion, si dhe e drejta për ta përfutur falas ndihmën ligjore.

Ligji për azilin e vendos parimin e interesit më të lartë të fëmijës në qendër të zbatimit të tij, në përputhje me konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Kërkesve fëmijë, sikurse kërkesve të tjerë, u sigurohet shërbimi i përkthimit në gjuhën amtare ose në një gjuhë të kuptueshme për fëmijën, që në momentet e para të informimit dhe këshillimit. Rregullat e konfidencialitetit janë edhe më të theksuara në rastin e trajtimit të FHPN-ve.

Gjatë kryerjes së procedurave për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, FHNP-të kanë të drejtë të qëndrojnë në RSH dhe u sigurohen kushtet minimale të jetesës për sa i përket strehimit, ushqimit dhe veshmbathjes, kujdesit shëndetësor, shërbimeve të kujdesit shoqëror, arsimit, formimit profesional ose punësimit në përputhje me moshën, si dhe ndihmë juridike e garantuar nga shteti. Ata gëzojnë të drejtën e ushtrimit të lirisë së mendimit, besimit fetar dhe gjithë të drejtat e tjera në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

QPA ose institucioni strehues duhet të plotësojë nevojat e domosdoshme për akomodim duke pasur parasysh grup-moshat dhe nevojat e tyre për ushqim sipas një diete të shëndetshme, por edhe arsim<sup>10</sup>. Të gjithë fëmijëve, sidomos atyre që kanë histori të mëparshme dhune dhe abuzimi, u sigurohet trajtim i nevojshëm shëndetësor sipas nevojave specifike për shëndetin fizik dhe mendor.

Në mënyrë të ngjashme me ligjin për azilin, edhe *Ligji për të huajt*<sup>11</sup>, i cili ofron dhe përkufizimin për fëmijët e pashoqëruar, e përfshin këtë kategori në grupin e personave të cenueshëm. Ky ligj parashikon rregulla më të veçanta për trajtimin e kësaj kategorie në rast të largimit të tyre nga RSH. FHPN përfshihen gjithashtu tek kategoria e personave që nuk mund të dëbohen. Në rrethana të veçanta, ndaj një FHPN-je mund të nxirret një urdhër ndalimi. Në këto raste, FHPN-ja mbahet në një qendër sociale shtetërore të posaçme ose një qendër tjetër të përshtatshme.

10 VKM Nr. 855, datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kushteve minimale të jetesës dhe kushteve sociale për kërkesit e mbrojtjes ndërkombëtare".

11 Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt".

Rregullat për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit janë parashikuar në ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror<sup>12</sup> dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, legjisllacion i cili përkufizon fëmijët në nevojë për mbrojtje të veçantë si individë që mund të jenë viktime të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes apo ndonjë veprimtarie kriminale.

Për sa i përket arsimit të FHPN-ve dhe regjistrimit në institucionet e arsimit parauniversitar, ligji për azilin përcakton afatet për realizimin e kësaj të drejte të fëmijës në bazë të *Ligjit për sistemin arsimor parauniversitar*<sup>13</sup> dhe ligjit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës. Një udhëzim specifik i ministrisë përgjegjëse për arsimin<sup>14</sup> rregullon më në detaje modalitetet e regjistrimit dhe vlerësimit nga komisioni ndërlëndor për përcaktimin e klasës ku FHPN-së i takon të regjistrohet, si dhe detyrat e institucionit arsimor publik për sigurimin e teksteve, organizimin e planit individual për mësimin e gjuhës dhe rolin e punonjësit të shërbimit psiko-social.

---

12 Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

13 Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

14 Udhëzim i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 10, datë 17.05.2021 “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijët viktime të trafikimit në Republikën e Shqipërisë”.

## Matrica e Veprimeve Procedurale

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
<p>Informimi dhe këshillimi në pikat e kalimit kufitar në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen me rastin e hyrjes dhe qëndrimit në Shqipëri.</p> <p>Kërkuesve u sigurohet ndihmë ligjore nga shteti, si dhe shërbimi i përkthimit në gjuhën që njohin.</p>	<p>Punonjësit e strukturave rajonale që mbulojnë çështjet e kufirit dhe migracionit në kufi;</p> <p>OJF</p>	Menjëherë	Struktura rajonale që mbulon çështjet e kufirit dhe migracionit.	<p>Neni 4, pika 1 e Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe Neni 4, pika 4 e Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”;</p> <p>Neni 22, 23 dhe 24 i Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p>Informimi i Strukturës Përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore në Bashki dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për konstatimin e një FHPN-je, referimi i rastit tek PMF-ja përgjegjës për territorin ku është fëmija.</p> <p>Informimi i FHPN-së për procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet, si dhe kushtet e pritjes.</p>	<p>Punonjësit e strukturave rajonale që mbulojnë çështjet e kufirit dhe migracionit, të policisë së shtetit apo strukturave për azilin dhe refugjatët.</p>	<p>Brenda (dymbëdhjetë) orëve nga konstatimi.</p>	<p>Struktura rajonale që mbulon çështjet e kufirit dhe migracionit.</p>	<p>Pika 10 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës”;</p> <p>Neni 27 i Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.</p>

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Vlerësimi fillestar i rastit të FHPN-së nëpërmjet verifikimit të gjeneraliteteve, vendbanimit, shtetësisë,	PMF; Psikolog; Përkthyes	Menjëherë	Njësia e mbrojtjes së fëmijës në bashkinë territorialeisht-kompetente për vendin ku ndodhet fëmija.	Pika 12 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”.
Përgatitja nga ana e PMF-së e një raporti të hollësishëm informues për arsyet e hyrjes dhe qëndrimit si i pashoqëruar në RSH dhe dërgimi i raportit në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.	PMF	Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga raportimi i rastit.	NjMF; Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës	Pika 12 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”.
Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes, i cili duhet të përfshijë edhe vlerësimin e rrezikut për trafikimin e fëmijës.	PMF; Punonjësit e institucionit të përkujdesjes sociale.	Menjëherë	NjMF; Drejtori i Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës; GTN	Ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës; VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”; VKM Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Referimi i rastit në bashkinë apo njësinë administrative ku ndodhet institucioni i përkujdesjes sociale ku do të vendoset fëmija, i cili mund të jetë Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilërkues ose Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, nëse FHPN-të janë njëhohësisht viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.	PMF; Punonjësit e institucionit të përkujdesjes sociale; Punonjësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët.	Menjëherë	NJMF	VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës".
Vendosja e FHPN-së në institucionet e përkujdesjes sociale me të afërmit e rritur, me ndonjë familje kujdestare, në qendra të specializuara për akomodimin për fëmijë ose një akomodim tjetër të përshtatshëm.	PMF; Punonjësit e institucionit të përkujdesjes sociale; Punonjësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët.	Menjëherë	Bashkia ose administrative	Neni 52 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
FHPN-të që kanë mbushur moshën 16 vjeç mund të vendosen në OPA për të rritur në rast se është në interesin e tij/saj, jep pëlqimin për këtë dhe vendoset në kujdestari të një të afërmi të rritur që ndodhet në OPA.				

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Regjistrimi i FHPN-së që ka kërkuar mbrojtje ndërkombëtare dhe referimi pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.	Punojësit e strukturave rajonale që mbulojnë çështjet e kufirit dhe migracionit në kufi.	Menjëherë dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pas paraqitjes së kërkesës dhe në rast të flukseve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë.	Struktura rajonale që mbulon çështjet e kufirit dhe migracionit.	Pika 14 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”;
Përgatitja dhe dhënia e mendimit në formë shkresore nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për autoritetet përgjegjëse për azilin dhe refugjatët në lidhje me qëndrimin në RSH të FHPN-së, bazuar në raportin e PMF-së dhe informacionit të siguruar nga burime të tjera.	Punojësit e Agjencisë - të Drejtave të Fëmijës	-	Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës; Organizatat ndërkombëtare	Pika 14 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”.
Marrja e vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes së FHPN-së bazuar në propozimin e PMF-së dhe GTN-së.	Drejtori i strukturës dhe shërbimeve shoqërore në bashki dhe PMF,  Anëtarët e GNT-së	Menjëherë	Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;  Njësia për mbrojtjen e fëmijës; Grupi Teknik Ndërsëktorial	Neni 48 i Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;  VKM Nr. 353, datë 12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të Grupit Teknik Ndërinstitucional për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”.

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Pas marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes, PMF deponizon në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative së bashku me kërkesën për kujdestari.	PMF; Gjyqtarët	Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit për masën e mbrojtjes.	Njësia për mbrojtjen e fëmijës; Gjykata kompetente	Neni 52 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
Paraqitja e kërkesës për mbrojtje nëpërmjet plotësimit të formularit që përfshin edhe mbledhjen e dëshmimeve në lidhje me kërkesën.	Punonjësit e strukturave rajonale që mbulojnë çështjet e kufirit dhe migracionit në kufi; Punonjësit e Policisë së Shtetit; Strukturat përgjegjëse për azilin dhe refugjatët; PMF/Kujdestari ligjor	Menjëherë	Struktura rajonale që mbulon çështjet e kufirit dhe migracionit; Stacioni më i afërt i Policisë së Shtetit; Specialistë për azilin dhe shërbimet ligjore falas.	Neni 26 dhe 27 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"; Neni 36 i Ligjit Nr. 79/2021 "Për të huajt".
Kryerja e vizitave mjekësore	Punonjësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët; Mjek specialist; Psikolog	Opsionale dhe vetëm për rastet kur nevojitet për të përcaktuar moshën.	Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët; QPA	Neni 53 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".



Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Informimi i vazhduar i kërkuetit gjatë qëndrimit në QPA dhe sigurimi i kushteve minimale të jetesës, përfshirë akomodim, duke respektuar kushtet minimale të jetesës, ushqim, shërbime shëndetësore, këshillim ligjor falas, programe pedagogjike edukimi.	Punonjësit e QPA; Punonjës të shëndetësisë dhe arsimit; Përkthyes	I n f o r m i m i r e a l i z o h e t b r e n d a 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mbërrirja në QPA dhe të tjerat menjëherë dhe në mënyrë të vazhduar	Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët	Neni 26 i Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.
Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në procedurë;	PMF (kur nuk është caktuar kujdestar ligjor për FHPN-në);	Menjëherë	Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët	Neni 29 dhe 30 i Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;
Intervista personale; Mbatja në konsideratë e mendimit të paraqitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijës.	Psikolog; Përkthyes			Pika 19 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës”.
Regjistrimi në arsimin parauniversitar i FHPN-së dhe trajtimi me plan individual për mësimin e gjuhës shqipe.	Punonjësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët; PMF; Punonjësit arsimorë.	Brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje.	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar	Neni 59 i Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
Kur FHPN ka marrë statusin e refugjatit, ai/ajo ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me anëtarët e familjes të shkallës së parë në linjë të drejtë dhe nëse këta nuk gjenden FHPN ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me kujdestarin ligjor ose të afërm të tjerë jo në linjë të drejtë.	Punojësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët; PMF	Pas marrjes së statusit të refugjatit.	Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët; Struktura të tjera përgjegjëse kombëtare dhe ndërkombëtare.	Neni 72 i Ligjit Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
Lëshimi i vendimit të kthimit të FHPN-së dhe garantimi i kthimit të sigurtë duke u siguruar që FHPN do të shkojë tek një anëtar i familjes, tek një kujdestar i emëruar ose institucion i përshtatshëm.	Punojësit e autoritetit përgjegjës për kufirin dhe emigracionin; PMF	Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe emigracionin; NjMF	Ligji për azilin dhe për të huajt.	Ligji për azilin dhe për të huajt.
Njoftimi i urdhrin të largimit apo kthimit të FHPN-së tek PMF-ja që ka ndjekur zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes së tij/saj.	Punojësit e strukturave përgjegjëse për azilin dhe refugjatët.	Menjëherë	Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.	Pika 24 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës".
Informimi i FHPN-së nga PMF-ja në lidhje me urdhrin e largimit apo kthimit të tij/saj.	PMF; Psikolog; Përkthyes	Brenda 3 (tre) ditëve nga njoftja me urdhrin.	NJMF	Pika 25 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riadhesimin e fëmijës".

Veprimet procedurale	Profesionistët e përfshirë	Afati	Institucioni përgjegjës/ Njësia përgjegjëse	Baza ligjore
<p>Ushtrimi i të drejtës së ankimit nga FHPN, nëpërmjet kujdestarit ligjor, në rast se i është refuzuar ose nuk është pranuar aplikimi për azil, leje qëndrimi apo i është revokuar vendimi i statusit të refugjatit.</p>	<p>Punonjësit e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; PMF</p>		NJMF	<p>Pika 26 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës".</p>
<p>Kthimi apo riatdhesimi i FHPN-së, nëse është në interesin me të lartë të tij/saj, bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës që merr parasysh nevojat individuale të fëmijës dhe mundësinë për t'i siguruar kthim të përshtatshëm, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës.</p>	<p>Personi përgjegjës për shoqërimin e fëmijës; PMF</p>	<p>Brenda afateve të ekzekutimit të urdhrit.</p>	<p>Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin.</p>	<p>Pika 32 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës".</p>
<p>Dorëzimi i FHPN-së tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit dhe dokumentimi i kësaj procedure. Përpilimi i një procesverballi të detajuar dhe dërgimi i një kopje të tij tek agjencia.</p>	<p>Personi përgjegjës për shoqërimin e fëmijës.</p>		<p>Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin; Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës</p>	<p>Pika 36 e VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës"</p>

Udhëzime të përgjithshme: Informimi dhe këshillimi në pikat e kalimit kufitar ofrohet menjëherë me mbërritjen e shtetasve të huaj ose pa shtetësi në këto pika. Ky informacion lidhet kryesisht me mundësitë ligjore për marrjen e statusit të refugjatit ose staturë të tjera për mbrojtje të përcaktuara në ligjin për azilin, si edhe procedurat që duhet të ndiqen. Secila procedurë iniciohet nga kërkuesit, të cilëve u ofrohet edhe ndihmë ligjore e garantuar nga shteti. Në rastet kur nuk njihin gjuhën, kërkuesve u ofrohet shërbim përkthimi në gjuhën e shtetit të origjinës ose gjuhë tjetër të njohur prej tyre.

Ndërsa shprehja e qëllimit për mbrojtje ndërkombëtare mund të paraqitet me shkrim ose verbalisht, kërkesa duhet të plotësohet me shkrim. Shtetasi që ka shprehur qëllimin për të kërkuar mbrojtje regjistrohet dhe referohet pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Procedura e shqyrtimit të kërkesës kryhet nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Në procedurë mund të jenë të pranishëm kujdestari ligjor i FHPN-së ose PMF-ja, kur nuk është caktuar një kujdestar. Kur gjykohet e arsyeshme, gjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë të FHPN-së mund të marrë pjesë dhe psikologu. Intervista personale me fëmijët kryhet në mënyrë të përshtatshme për ta.

FHPN-ve, pjesë e kategorive të veçanta të përkufizuara nga ligji, u kushtohet vëmendje, trajtim dhe kujdes i veçantë. FHPN-të vendosen, kur është e mundur, me të afërmit e rritur ose familje kujdestare. Ata mund të vendosen në qendra të specializuara për fëmijët ose në ndonjë akomodim tjetër të përshtatshëm dhe përfitojnë trajtim special, në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin mjekësor dhe këshillimin e duhur psiko-social. Për sa është e mundur, vëllezërit dhe motrat duhet të akomodohen në të njëjtin vend. Si rregull i përgjithshëm, ndryshimet e vendqëndrimit të FHPN-ve duhet të kufizohen sa më shumë të jetë e mundur.

Që nga identifikimi i FHPN-së, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare merr masa për gjurmimin e gjetjen e prindërve ose të afërmeve të FHPN-së.

Caktimi i kujdestarit për FHPN-në realizohet nëpërmjet një procedure që iniciohet nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, i cili njofton strukturën e shërbimeve shoqërore në bashki.

## Bibliografi

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”;

VKM Nr. 659, datë 03.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026”;

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

VKM Nr. 111, datë 06.03.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës”;

VKM Nr. 855, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kushteve minimale të jetesës dhe kushteve sociale për kërkuesit e mbrojtjes ndërkombëtare”;

VKM Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;

VKM Nr. 353, datë 12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të Grupit Teknik Ndërinstitucional për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”;

VKM Nr. 186, datë 04.04.2019 “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët;

VKM Nr. 565, datë 29.09.2018 “Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionale dhe strukturave në nivel qendror e vendor për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 10, datë 17.05.2021 “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijëve viktime të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”.





